



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec  
Opština Skupština Rahovec / Municipality of Rahovec

RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/22 Nr. ifaq./Br. nr./No. pa 394

Data/Datum/Dat 25.11.2022

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 14, nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 6 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 8 paragrafi 1 pika 1.3, nenit 11 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 2 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019"), nenit 5 paragrafi 1 pika 1.3, nenit 13 dhe nenit 23 paragrafi 2 pika 2.1 lidhur me paragrafin 6 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë:25.11.2022 merr këtë:

### V E N D I M

#### Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës me negocim

1. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës Nr. 02/2979/22 i datës 14.11.2019 dhe merret vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik në shfrytëzim afatgjatë nga 15 (pesëmbëdhjetë) deri në 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite me negocim të Kryetarit të Komunës.
2. Prona e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 të këtij vendimi, është në zonën kadastrale Rahovec në vendin e quajtur Groblje, me kulturë mal i klasës 1, e evidentuar sipas Certifikatës së pronësisë Nr. P-71510057-08924-0, në emër të Komuna e Rahovecit me sipërfaqe të përgjithshme prej 3402m<sup>2</sup> (tre mijë e katërqind e dy metra katror) dhe i IPET në shfrytëzim Fondacionit "ADRIAN ORLLATI" me seli në Laussane të Zvicrës, me Presidente të Foncacionit znj. Micheline Calmy Rey dhe përfaqësues z. Avni Orllati.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është ndërtimi i objektit për strehimin dhe kujdesin ndaj personave të shtyer në moshë, të cilët janë pa përkujdesje dhe në gjendje jo të mirë ekonomike, i cili investim është për qëllime humanitare dhe bamirësie dhe se vlera e investimit është 1,100,000.00€ (një milion e njëqindmijë euro), me çka tejkalohe vlera prej 10% e buxhetit të përgjithshëm për investime kapitale të komunës për vitin paraprak 2021 (Investimet kapitale komunale për vitin 2021 kanë qenë 4,286,979.00€, kurse 10% e kësaj vlere është 428,697.90€).

4. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme komunale, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi është afatgjatë në periudhën prej 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite dhe ipet në shfrytëzim pa kompensim.
5. Obligohet Fondacioni “ADRIAN ORLLATI” me seli në Laussane të Zvicrës, me Presidente të znj. Micheline Calmy Rey dhe përfaqësues z. Avni Orllati, që në afat prej 3 (tre) vitesh nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi të filloj punët ndërtimore, në të kundërtën do t’i mirët e drejta e shfrytëzimit të pronës komunale.
6. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t’i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.
7. Obligohet Kryetari i Komunës që pas miratimit të këtij vendimi të përcaktoj me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim, respektivisht Fondacionit “ADRIAN ORLLATI” me seli në Laussane të Zvicrës, me Presidente të Foncacionit znj. Micheline Calmy Rey dhe përfaqësues z. Avni Orllati.
8. Për zbatimin e këtij propozimi do të kujdeset Kryetari I Komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit.
9. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

**Vendimi u dërgohet:**

- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *MAPL-së,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.394/22  
Me datë: 25.11.2022

